

Program i Përbashkët i ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” në Arkeologji, Histori dhe Administrim i Pasurive Kulturore-ASPIC

Emërtimi akademik i studimit	DIPLOMË E PËRBASHKËT “Master i Shkencave”
Statusi i Akreditimit të programit të studimit	Në proces
Cikli i studimit	Cikli i dytë i studimeve “Master i Shkencave”
Emri dhe statusi i insitucionit	Universiteti “Eqrem Çabej” Fakulteti i Edukimit dhe Shkencave Shoqërore në bashkëpunim me Universitetin e Macerates – Itali
Gjuha e përdorur në mësimdhënie/provime	Shqip
Kohëzgjatja zyrtare e programit të studimit	2 (dy) vite
Forma e studimit	Me kohë të plotë
Kushtet e pranimi	a.Pranimi i studentëve në këtë program studimi është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses një program të ciklit të parë të studimeve “Bachelor”. b. Kriter pranimi në këtë program të ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” është njohja nga kandidati e një prej 5 (pesë) gjuhëve të huaja të Bashkimit Europian: (<i>anglisht,frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht</i>), në nivelin B1, sipas akteve nënligjore të MAS-it. Nëse kandidati ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri. c. Njësia Bazë e Historisë, Antropologjisë dhe Gjeografisë mund të njohë kredite të fituara në programet e ciklit të dytë “Master Profesional”, me qëllim transferimin e tyre në programin e studimit të ciklit të dytë “Master i Shkencave”. d. Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare, deri në plotësimin e kuotave të shpallura. Në rast se numri i aplikimeve kalon kuotën e parashikuar të pranimeve nga Njësia Bazë, atëherë kandidatët do të seleksionohen sipas nivelit të përshtatshmërisë së diplomës “Bachelor”, për vazhdimin e programit të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave” në “Arkeologji, Histori dhe Administrim i pasurive Kulturore-ASPIC.

OBJEKTIVAT DHE VEPRIMTARITË FORMUESE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Programi i studimit Master i shkencave “Arkeologji, histori dhe administrim i pasurive kulturore-ASPIC”, synon të pajisë studentin me:

- Aftësi shkencore, teorike, metodologjike dhe operative që lidhen me sektorët e arkeologjisë dhe të historisë së artit antik, duke iu referuar në mënyrë të veçantë tematikave që ofrojnë trevat si shqiptare dhe italiane dhe më gjerë.
- Aftësi në sektorët e administrimit, konservimit dhe restaurimit të pasurive arkeologjike, artistike, dokumentare, monumentale etj.
- Aftësi në përdorimin e mjeteve informatike dhe të komunikimit elektronik, për të bërë klasifikimin e gjetjeve dhe trajtimin e pamjeve (imazheve), si dhe për të bërë administrimin informatik të materialeve të shkruara.
- Aftësi për të përdorur në mënyrë të rrjedhshme, të shkruar dhe të folur, të paktën një nga gjuhët e Bashkimit Europian.

Qëllimi i këtij programi është të ofrojë një formim profesional përmes njohurive komplekse të cilat, në tërësinë e tyre fokusohen tek shkenca e arkeologjisë dhe menaxhimi i pasurive arkeologjike, historike dhe kulturore. Këto njohuri do ti shërbejnë studentëve të diplomuar jo vetëm në aspektin e punësimit në tregun kombëtar dhe vendeve të BE-së, por edhe si bazë për të transferuar kreditet e grumbulluara gjatë studimeve të kryera në studimet e ciklit të dytë në këtë degë apo të tjera të ngjashme me të.

VEPRIMTARITË FORMUESE

I. LËNDË TË FORMIMIT TË PËRGJITHSHËM:

1. Epigrafia latine
2. Arkeologjia e Evropës juglindore dhe e Adriatikut

KREDITE (12ECTS)

II. LËNDË TË FORMIMIT KARAKTERIZUES:

1. Epigrafia greke
2. Gjeografia humane
3. Muzeologjia dhe Muzeografia
4. Gjeografia historike
5. Arkeologjia e krishterë dhe mesjetare
6. Metodologjitë e kërkimit arkeologjik
7. Qytetërimi bizantin
8. Historia e Romës dhe e Mesdheut antik
9. Arkeologjia klasike

KREDITE (60ECTS)

III. LËNDË INTEGRUESE:

1. Etnoarkeologjia

LËNDË ME ZGJEDHJE: (Viti I, semestri II):

1. Teoria dhe historia e restaurimit
2. Historia e epokës së iluminizmit
3. Historia e mendimit arkeologjik
4. Arkeologjia e shoqërive paraurbane dhe urbane

LËNDË ME ZGJEDHJE: (Viti I, semestri II):

1. Antikiteti grek
2. Ekonomia dhe administrimi i trashëgimisë kulturore
3. Numizmatika
4. Arkeologjia dhe historia për didaktikën e muzeut dhe parkut arkeologjik

LËNDË ME ZGJEDHJE: (Viti II, semestri II):

1. Historia e Evropës mesjetare
2. Historia e artit evropian
3. Historia ekonomike
4. Historia e Evropës moderne

LËNDË ME ZGJEDHJE: (Viti II, semestri II):

1. Gjeografia fizike dhe gjeomorfologjia
2. Gjeologjia e aplikuar
3. Mitologjia
4. Prehistoria e Shqipërisë

KREDITE (24 ECTS)

IV. LËNDË TË FORMIMIT PLOTËSUES:

1. Aftësi gjuhësore
2. Praktikë gjurmimesh arkeologjike në Hadrianopolis (Viti I)
3. Praktikë gjurmimesh arkeologjike në luginën e Drinos (Viti II)

KREDITE (12 ECTS)

V. PUNIM DIPLOME:

KREDITE (12 ECTS)

SKEMA E VLERËSIMIT

Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem notash nga 1 deri në 10, ku notat kanë kuptimin e mëposhtëm : 1-4 (mbetës), 5 (mjaftueshëm), 6 (kënaqshëm), 7-8 (mirë), 9 (shumë mirë), 10 (shkëlqyer).

Gjatë provimit aplikohet një sistem pikësh, rezultatet e të cilave konvertohen në nota bazuar në skemën e mëposhtme:

NOTA	PIKËT
4 (katër)	0 në 44 pikë
5 (pesë)	45 -54 pikë
6 (gjashtë)	55 -64pikë
7 (shtatë)	65 -74 pikë
8 (tetë)	75 – 84 pikë
9 (nëntë)	85 – 94 pikë
10 (dhjetë)	95 – 100 pikë

MUNDËSITË E PUNËSIMIT DHE KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

Një diplomë universitare me titull “*Master i shkencave në Histori dhe arkeologji për inovacion*” dhe “*Administrim i pasurive kulturore historike dhe arkeologjike*” është mjaft fleksibël për sa u përket mundësive që kanë studentët për punësim, si specialistë që mund të punësohen në :

- Zyrat teknike të enteve publike: Ministria e Kulturës, Qarqet e rretheve, Bashkitë etj.
- Institucionet e lidhura me ruajtjen, menaxhimin dhe studimin e pasurisë arkeologjike.
- Instituti i monumenteve të kulturës, drejtoritë rajonale të monumenteve të kulturës, qarqet arkeologjike, zyrat e trashëgimisë kulturore, Instituti Albanologjik etj.
- Në organizmat private që kanë për objekt studimin dhe menaxhimin e vlerave arkeologjike.
- Në universitete vendase dhe të huaja që kanë për objekt studimi trashëgiminë kulturore.

DETAJET E PROGRAMIT TË STUDIMIT (plani mësimor)

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
VITI I PARË				
1.	Epigrafia latine	6	150	II
2.	Arkeologjia e Evropës juglindore dhe e Adriatikut	6	150	II
3.	Epigrafia greke	6	150	I
4.	Gjeografia humane	9	225	I
5.	Muzeologjia dhe Muzeografia	6	150	I
6.	Gjeografia historike	9	225	I
7.	Lënd me zgjedhje:			
	Teoria dhe historia e restaurimit	6	150	II
	Historia e epokës së iluminizmit			
	Historia e mendimit arkeologjik			
	Arkeologjia e shoqërive paraurbane dhe urbane			
8.	Lënd me zgjedhje:			
	Antikiteti grek	6	150	II
	Ekonomia dhe administrimi i trashëgimisë kulturore			
	Numizmatika			
	Arkeologjia dhe historia për didaktikën e muzeut dhe parkut arkeologjik			
9.	Aftësi gjuhësore	3	75	II
10.	Praktikë gërmimesh arkeologjike në Hadrianopolis	3	75	II
Gjithësej viti i parë		60 ECTS	1500	

Nr.	Lënda	ECTS	Orë gjithësej	Semestri
VITI I DYTË				
1.	Arkeologjia e krishterë dhe mesjetare	6	150	I
2.	Metodologjitë e kërkimit arkeologjik	6	150	I
3.	Qytetërimi bizantin	6	150	I
4.	Historia e Romës dhe e Mesdheut antik	6	150	I
5.	Arkeologjia klasike	6	150	I
6.	Etnoarkeologjia	4	100	II
7.	Lëndë me zgjedhje :			
	Historia e Evropës mesjetare	4	100	II
	Historia e artit evropian			
	Historia ekonomike			
	Historia e Evropës moderne			
8.	Lëndë me zgjedhje :			
	Gjeografia fizike dhe gjeomorfologjia	4	100	II
	Gjeologjia e aplikuar			
	Mitologjia			
	Prehistoria e Shqipërisë			
9.	Praktikë gërmimesh arkeologjike në luginën e Drinos	6	150	II
10.	Punim diplome	12	300	II
Gjithësej viti i dytë		60 ECTS	1500	
Gjithësej viti i parë + viti i dytë		120	3000	